



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË

URDHËR

Nr. 28 datë 18/01/2021

PËR
MIRATIMIN E UDHËRRËFYESIT PËR HAPJEN E TREGUT DHE DE-
RREGULLIMIN E ÇMIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës, të Ligjit Nr. 43 datë 30.04.2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, të Ligjit Nr. 7/2017 “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 742, datë 12.12.2018 “Për miratimin e planit strategjik për reformimin e sektorit të energjisë në Shqipëri”,

URDHËROJ:

1. Miratimin e udhërrëfyesit për hapjen e tregut dhe de-rregullimin e çmimit të energjisë elektrike, sipas tekstit bashkëlidhur dhe pjesë e këtij urdhri.
2. Ngarkohen strukturat përkatëse në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, OST sh.a, OSHEE Group sh.a, KESH sh.a dhe ALPEX sh.a, për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI


Befinda Balluku



Dhjetor 2020

Hapja e tregut dhe de-rregullimi i çmimit

Përmbajtja

1. Hyrje
2. Përshkrimi i kuadrit ligjor dhe progresi aktual në de-rregullimin e çmimit.
- 2.1. Interpretimi dhe transpozimi në Palët Kontraktuese të Traktatit të Komunitetit të Energjisë
- 2.2. Ligji i vitit 2015 mbi sektorin e energjisë elektrike
- 2.3. Progresi i deritanishëm i hapjes së tregut në Shqipëri
3. Afatet kohore të de-rregullimit për konsumatorët e lidhur në nivelin e tensionit të rrjetit të shpërndarjes
 - 3.1. Parakushte
 - 3.2. Faza e parë – Nga 1 Janari 2021
 - 3.3. Faza e dytë – Nga 1 Janari 2022
 - 3.4. Likuiditeti i ALPEX dhe detyrimi për të blerë nëpërmjet bursës së energjisë
 - 3.5. Modeli i Kontratës për Diferencë

Dokument Udhërrëfyes

1. Hyrje

Republika e Shqipërisë është palë kontraktuese në Traktatin e Komunitetit të Energjisë dhe si e tillë duhet të transpozojë dhe zbatojë Acquis Communautaire për Energjinë në legjislacionin e saj kombëtar. Në fushën e deregullimit të tregut të energjisë elektrike kjo përfshin Direktivën 2009/54/EC për rregullat e përbashkëta të tregut të brendshëm të energjisë elektrike (Direktiva e Energjisë Elektrike).

Direktiva mbi Energjinë Elektrike, e cila vendos themelet për hapjen e tregut të energjisë elektrike, është transpozuar në Ligjin e sektorit të energjisë elektrike¹ 43/2015, i ndryshuar në 2018, i cili përcakton kuadrin e afateve për hapjen e tregut dhe de-rregullimin e tarifave të përdoruesve fundor në vend. Bazuar në këto afate, në 2016 Qeveria Shqiptare ka miratuar Vendimin e Këshillit të Ministrave mbi Modelin e Tregut të Energjisë² i cili përcakton volumet e energjisë për tu de-rregulluar pas nisjes së funksionimit të Bursës së Energjisë të Shqipërisë (ALPEX).

Ky dokument udhërrëfyes përshkruan vizionin e Qeverisë Shqiptare për të mbështetur zbatimin e Modelit të Tregut të Energjisë duke përcaktuar planet për de-rregullim në vijim të krijimit së fundi të Bursës së Energjisë Shqiptare. Dokumenti është i organizuar si më poshtë:

- Kapitulli 2 paraqet një përshkrim gjithëpërfshirës mbi kuadrin ligjor i cili rregullon procesin e de-rregullimit të çmimit;
- Kapitulli 4 propozon afatet kohore për de-rregullimin për Qeverinë Shqiptare

2. Përshkrimi i kuadrit ligjor dhe progresi aktual në de-rregullimin e çmimit.

Ky kapitull pasqyron kërkesat e Direktivës mbi energjinë elektrike dhe mënyrën e transpozimit në Ligjin e sektorit të Energjisë Elektrike.

2.1. Direktiva e energjisë elektrike dhe de-rregullimi

Nën kapitullin të cilin mbulon Rregullat e Përgjithshme për organizimin e sektorit, Direktiva e energjisë elektrike përcakton se Palët Kontraktuese duhet të sigurojnë se të gjithë konsumatorët familjar dhe, kur Palët Kontraktuese e konsiderojnë të përshtatshme, sipërmarrjet e vogla, të gëzojnë të drejtën për shërbim universal. Direktiva për energjinë elektrike përkufizon shërbimin universal si furnizimi i një sasive të caktuar të energjisë elektrike me çmim të arsyeshëm, të krahasueshëm lehtësisht, transparent dhe jo-diskriminues, për të cilën Palët Kontraktuese mund ta sigurojnë duke caktuar një furnizues të mundësisë së fundit³. Direktiva përkufizon si të vogla sipërmarrjet të cilat kanë më pak se 50 punonjës ose më pak se 10 milion euro xhiro vjetore.

2.2. Interpretimi dhe transpozimi në Palët Kontraktuese të Traktatit të Komunitetit të Energjisë

Transpozimi i këtij detyrimi në legjislacionin kombëtar ndryshon ndërmjet Palëve Kontraktuese të Traktatit të Komunitetit të Energjisë dhe këto variacione kanë ndikuar në zbatimin e de-rregullimit të çmimit për dy arsye kryesore:¹

- Palët kontraktuese në përgjithësi kanë interpretuar domethënien e termit “çmime të arsyeshme” si : Konsumatorët sipas kritereve të përcaktuara në direktivë (familjar dhe sipërmarrje të vogla) kanë të drejtën e një forme mbrojtje me anë të rregullimit të çmimit. Kjo nuk është gjithmonë e vërtetë sepse në rast se tregu është mjaftueshëm eficient dhe efektiv sa të prodhojë çmime të arsyeshme atëherë rregullimi i çmimit nuk është i domosdoshëm dhe,
- Palët Kontraktuese kanë transpozuar në mënyrë jo të njëtrajtshme kriterin e “sipërmarrjeve të vogla” të përcaktuar në Direktivë për shkak të dy sfidave kryesore : (i) shoqëritë e sektorit të energjisë elektrike dhe rregullatorët në përgjithësi nuk kanë të dhëna lehtësisht të aksesueshme për numrin ne punonjësve dhe stafit të sipërmarrjeve të vogla në vend, dhe (ii) xhiro vjetore dhe numri i punëtorëve mund të ndryshojë nga viti në vit, duke nënkuptuar se këto konsumatorë mund të ndryshojnë statusin e kualifikimit për furnizim universal, duke paraqitur një tjetër sfidë në transpozim. Për ti kaluar këto sfida, Palët Kontraktuese kanë zgjedhur ose një de-rregullim gradual duke kategorizuar konsumatorët sipas nivelit të voltazhit, ose sipas një kombinimi midis nivelit të voltazhit dhe tipologjisë së konsumatorit, ose sipas një kombinimi midis tipologjisë së konsumatorit dhe volumit, ose një kombinim të të tre faktorëve të sipërpërmendur.

2.3. Ligji i vitit 2015 mbi sektorin e energjisë elektrike

Neni 109 i Ligjit të Sektorit të Energjisë Elektrike parashikon një afat kohor për de-rregullimin e sektorit dhe konsumatorëve të cilët duhet të furnizohen nga “tregu i liberalizuar”. Ai nis me konsumatorët e lidhur në nivelin e tensionit 110 kV ose konsumatorët me të paktën 50 milion kWh të cilët janë të de-rregulluar duke filluar nga data e hyrjes në fuqi të ligjit dhe gradualisht vazhdon de-rregullimin duke përfunduar në konsumatorët në nivelin 0.6 kV të cilët ishin parashikuar të de-rregulloheshin deri në fund të vitit 2017. Me rëndësi është fakti se ky Nen përcakton se konsumatorët e lidhur në nivelin e tensionit 0.4 kV kanë të drejtën të “zgjedhin lirisht furnizuesin e tyre”. Ky parashikim i fundit në këtë Nen lejon të gjithë konsumatorët, duke përfshirë sipërmarrjet, pavarësisht përmasave të tyre, që janë të lidhura në nivelin e tensionit 0.4 kV të kenë mundësi të zgjedhin furnizuesin e tyre. Kjo do të thotë se ata kanë të drejtë të zgjedhin një furnizues i cili ka detyrimin e shërbimit publik për të furnizuar energji nëpërmjet tarifave të rregulluara, nëse tarifat e rregulluara ekzistojnë në vend.

Neni 83 i Ligjit të Sektorit të Energjisë Elektrike përkufizon se furnizuesit e ngarkuar me detyrimin e shërbimit universal duhet të furnizojnë konsumatorët e tyre me tarifa të rregulluara dhe kjo nuk do të përfshijë konsumatorët të cilët sipas Nenit 109 të Ligjit, furnizohen në tregun e liberalizuar të energjisë elektrike. Ky koncept fuqizohet më tej nga Neni 85 i ligjit, i cili përcakton se ERE vendos tarifat e përdoruesve fundor për furnizuesin e shërbimit universal sipas Nenit 83.

Bazuar nga sa shtjellohet me sipër, Ligji i sektorit të energjisë elektrike ka transpozuar kërkesën e Direktivës së energjisë elektrike mbi “çmimin e arsyeshëm” duke i dhënë kuptimin se konsumatorët në fjalë furnizohen me çmime të rregulluara dhe ka kategorizuar të gjithë

konsumatorët familjar dhe "sipërmarrjet e vogla" në kategorinë e konsumatorëve të cilat furnizohen në nivelin 0.4 kV.

Ky interpretim nënkupton se de-rregullimi i detyrueshëm i çmimit do të aplikohet për kërkesën e të gjithë konsumatorëve përveç atyre në nivelin e tensionit 0.4 kV. Megjithatë nuk është e detyrueshme, të gjithë konsumatorët e lidhur në nivelin 0.4 kV, duke përfshirë dhe konsumatorët familjar, do të kenë mundësinë të furnizohen nga furnizuesit e tregut të lirë.

Neni 69, paragrafi f, i Ligjit të sektorit të energjisë elektrike, kërkon që Operatori i Sistemit të Shpërndarjes duhet të krijojë dhe aplikojë Profilet e Standartizuara të Ngarkesës për kategoritë e ndryshme të konsumatorëve, për të lejuar llogaritjen e disbalancave aty ku të dhënat e matjes mungojnë. Aty ku të dhënat e matjes mungojnë, Operatori i Shpërndarjes së Energjisë duhet të sigurohet që do të aplikojë Profilet e Standartizuara të Ngarkesës për të lejuar kalimin eficient të konsumatorëve në furnizues të tjerë, pavarësisht nëse kalimi është i detyruar apo vullnetar. Neni 86, paragrafi f nuk duhet të pengojë kalimin e konsumatorëve në tregun e de-regulluar.

2.4. Progresi i deritanishëm i hapjes së tregut në Shqipëri

Pavarësisht nga disa pengesave në hapjen e tregut të energjisë në Shqipëri për shkak të vonesave në hyrjen në funksion të Bursës së Energjisë Shqiptare, volume të konsiderueshme janë aktualisht duke u furnizuar nëpërmjet tarifave të parregulluara.

I gjithë konsumi prej 867 GWh në nivelin e transmetimit (konsumatorët të cilët furnizohen në nivelin 110 kV ose më nivel më të lartë), konsumatorët në nivelin 35 kV, si dhe humbjet në transmetim bashkë me vetë-konsumin (168GWh) janë aktualisht duke u furnizuar me tarifa të parregulluara. Për vitin 2019 këto volume të energjisë përbejnë më shumë se 13% të konsumit total brenda vendit (7,612 GWh) ⁴.

Për qëllimet e këtij udhërrëfyese këto volume nuk do të konsiderohen më në afate kohore të de-rregullimit të çmimit meqenëse ky konsum po furnizohet tashmë në një treg të liberalizuar.

3. Afatet kohore të de-rregullimit për konsumatorët e lidhur në nivelin e tensionit të rrjetit të shpërndarjes

Ky kapitull i këtij raporti prezanton planin e Qeverisë Shqiptare për të mbështetur zbatimin e Modelit të Tregut Shqiptar dhe paraqet afatet kohore për të zbatuar de-rregullimin e furnizimit për konsumatorët e lidhur në nivelin e tensionit të rrjetit të shpërndarjes, përveç atyre që furnizohen në nivelin e tensionit 0.4 kV. Kategoria e konsumatorëve të lidhur në nivelin e tensionit 0.4 kV janë subjekt i kalimit vullnetar në tregun e de-regulluar.

3.1. Parakushte

Afatet kohore të de-rregullimit, bashkë me volumet përkatëse, të prezantuara në këtë kapitull, varen nga një listë parakushtesh të cilat janë të përmbledhura më poshtë:

- Të gjithë konsumatorët të cilët furnizohen në nivelin 0.4 kV, sipas ligjit 43/2015 të sektorit të energjisë elektrike, kanë të drejtën për të zgjedhur furnizuesin e tyre;
- Si rrjedhojë, de-rregullimi i detyrueshëm në përputhje me ligjin do të mund të aplikohet vetëm për konsumatorët e lidhur në nivelin e tensionit mbi 0.4 kV;

3.2. Faza e parë – Duke filluar nga 1 Janari 2021

Në fazën e parë të de-rregullimit, parashikohet se i gjithë furnizimi në nivelin 35 kV dhe një pjesë e furnizimit në nivelin 20 kV do të furnizohet nëpërmjet një tregu të parregulluar. Këto kategori konsumatorësh do të furnizohen nëpërmjet tarifave të de-regulluara duke filluar nga data 1 Janar 2021.

Tregu i rregulluar			
Blerjet MWh		Shitjet (MWh)	
Tarifat e rregulluara në nivelet 20, 10, 6 and 0.4 kV	5,127,835	3,950,000	KESH
		1,177,835	ALPEX
Total	5,127,835	5,127,835	Total
Tregu i parregulluar			
Blerjet MWh		Shitjet (MWh)	
Konsumatorët në 35 kV	80,120	1,532,020	ALPEX
Konsumatorët në 20 kV	85,308		
Humbjet e OSSH	1,366,592		
Total	1,532,020	1,532,020	Total

3.3. Faza e dytë – Duke filluar nga Janari 2022

Në fazën e dytë të de-rregullimit parashikohet që i gjithë furnizimi në të gjitha nivelet e tensionit, përveç nivelit 0.4 kV, do të furnizohen në çmime të parregulluara. Këto kategori konsumatorësh do të furnizohen nëpërmjet tarifave të de-regulluara duke filluar nga data 1 Janar 2022.

Tregu i rregulluar			
Blerjet MWh		Shitjet (MWh)	
Tarifat e rregulluara në nivelin 0.4 kV	4,887,058	3,950,000	KESH
	N/A	937,058	ALPEX
Total	4,887,058	4,887,058	Total
Tregu i parregulluar			
Blerjet MWh		Shitjet (MWh)	
	N/A	N/A	
Blerjet në voltazhin e lartë		1,786,468	ALPEX
Konsumatorët në 35 kV	80,563		
Konsumatorët në 20 kV	245,086		
Konsumatorët në 10/6 kV	109,833		
Konsumatorët në 0.4 kV			
Humbjet e OSSH	1,350,987		
Total	1,786,468	1,786,468	Total

Duke kombinuar sasitë më lart me sasitë e kërkesës aktuale të de-rregulluar në nivelin e tensionit të transmetimit, arrihet të paktën 2,800 GWh furnizim në çmime të parregulluara, ose 37% e kërkesës. Kjo duke supozuar se asnjë konsumator në nivelin e tensionit 0.4 kV do ta

shtrojë të drejtën për tu furnizuar nga një furnizues tjetër përveç furnizuesit të shërbimit universal.

Për të fuqizuar më tej këtë të drejtë të konsumatorëve të nivelit 0.4 kV, dhe njëkohësisht për të garantuar se familjarët nuk do të ekspozohen ndaj çmimeve të energjisë volatile afatshkurtra gjatë de-rregullimit, do të merren masat më poshtë gjatë vitit 2021.

3.4. Likuiditeti i ALPEX dhe detyrimi për të blerë nëpërmjet bursës së energjisë

Ky dokument udhërrëfyes pranon se Bursa Shqiptare e Energjisë duhet të arrijë disa nivele të caktuara minimale të likuiditetit që të mund të sigurojë prodhimin e çmimeve në mënyrë të qëndrueshme dhe efikase. Një element me rëndësi kritike në këtë proces është vazhdimi i de-rregullimit të çmimeve në përputhje me VKM Nr. 519 mbi modelin e tregut. Gjithashtu me rëndësi kritike është edhe detyrimi ndaj furnizuesve që shërbejnë konsumatorët e parregulluar për të blerë energjinë ekskluzivisht nëpërmjet bursës së energjisë Shqiptare. Gjithashtu, në përputhje me VKM Nr. 519, humbjet e transmetimit dhe shpërndarjes do të blihen nëpërmjet bursës së energjisë.

Një përmbledhje e volumeve të sipërpërmendura paraqitet në tabelën më poshtë :

Pjesëmarrësi në treg	Volumi (TWh)
Tregu aktual i de-rregulluar (110 and 35 kV)	1.1
Humbje në shpërndarje	1.4
Humbjet e transmetimit	0.2
Kërkesat e FSHU jashtë kontratës së detyrimit të shërbimit publik (PSO) ⁵ me KESH	1.2
Volumet totale	3.9

Është i njohur fakti se politikat e sektorit duhet të rrisin volumet në furnizim. Vendimi i Këshillit të Ministrave për themelimin e Operatorit të Energjive të Rinovueshme dhe skemës mbështetëse të Kontratës për Diferencë, vendos një detyrim për të gjithë energjinë elektrike të prodhuar nga prodhuesit me përparësi nga burimet e rinovueshme për të vendosur prodhimin e tyre fizikisht në ALPEX. Gjithashtu KESH do të detyrohet të tregtojë nëpërmjet ALPEX të gjitha volumet e pa kontraktuara me Furnizuesin e Shërbimit Universal. Importi dhe eksporti mundësohet nëpërmjet të drejtës për transmetim fizik ose nepermjet një alokimi të nënkuptuar.

Një model i Kontratës për Diferencë do të miratohet deri në 30 Qershor 2021, sipas përkufizimeve më poshtë me qëllim për të rritur më tej likuiditetin e ALPEX dhe për të përforcuar modelin e tregut sipas VKM Nr. 519 dhe gjithashtu për të mbështetur zbatimin e VKM mbi Operatorin e Energjive të Rinovueshme. Ky model do të miratohet nga një Vendim i Këshillit të Ministrave. Bashkë me miratimin e VKM do të detajohen më tej përcaktimet për implementimin dhe aplikimin e KpD.

Volumet e blera në tregun vendas do të prokurohen ekskluzivisht nëpërmjet tregut (ALPEX) në përputhje me përcaktimet e Ligjit 43/2015 të sektorit të energjisë elektrike (i ndryshuar), pavarësisht origjinës së energjisë në fjalë.

3.5. Modeli i Kontratës për Diferencë

Ministria përgjegjëse për energjinë në bashkëpunim me Entin Rregullator të Energjisë (ERE) do të hartojë dhe miratojë modelin e Kontratës për Diferencë (KpD) i cili mbështet zbatimin e Modelit të Tregut Shqiptar dhe VKM për krijimin e Operatorit të Energjive të Rinovueshme. Modeli i KpD, i cili do të miratohet nga një Vendim i Këshillit të Ministrave, do të jetë instrumenti i cili në të ardhmen do të sigurojë rregullimin e çmimit në tregun e rregulluar, gjithashtu duke promovuar likuiditetin në ALPEX.

Do të aprovohen modeli i KpD.

Modeli i KpD:

- Do të propozohet nga Ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë, miratohet nga Këshilli i Ministrave.
- Do të nënshtrohet një procedure të hapur, transparente dhe efektive konsultimi, sipas legjislacionit përkatës dhe precedentëve të ngjashëm.
- Do të dërgohet për shqyrtim dhe miratim tek Sekretariati i Komunitetit të Energjisë përpara miratimit nga Këshilli i Ministrave.

Vendimi i Këshillit të Ministrave për miratimin e modelit të Kontratës për Diferencë do të përcaktojë palët në treg për të cilat aplikohet modeli i Kontratës për Diferencë, në përputhje me kërkesat e Modelit të Tregut Shqiptar.

Modeli i Kontratës për diferencë do të miratohet brenda 6 muajve të parë të 2021 dhe përpara hyrjes në fuqi të Bursës Shqiptare të Energjisë.

- 1- Ligj nr. 43/2015 për sektorin e energjisë elektrike, i ndryshuar <http://www.akbn.gov.al/ligj-nr-432015-per-sektorin-e-energjise-elektrike-ndryshuar-me-ligjin-nr-72018-date-15-2-2018/>
- 2- VKM 519/2016 "Per miratimin e modelit te tregut te enregjise elektrike"
https://www.ere.gov.al/doc/Vendim_i_KM_519_13.07.2016.pdf
- 3- Direktiva e energjise elektrike 2009/28/EC Neni 3.3 "Detyrimi i sherbimit public dhe mbrojtja e konsumatorit"
<https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/PDF/?uri=CELEX:32009L0072&from=EN>
- 4- Raporti vjetor i ERE per 2019 https://ere.gov.al/doc/Raporti_vjetor_2019_perfundimtar.pdf
- 5- Nivelet aktuale të volumeve nën Detyrimin për Sherbim publik të KESH, janë të pamjaftueshme për të mbuluar kërkesën totale të FSHU, edhe sipas skenarit optimist në të cilin e arrijnë nivelin e kërkuar 3.95 TWh.